



|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Priljeno/Prodato<br>Received/Delivered | 17 - 11                       | 1                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njësia<br>Organ /Jedimica<br>Org /Unit                | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojta<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKPMGHCK   | 5498/2021                     |                               | 1/4                           |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.846/2021**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku-Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën e datës 04.10.2021 me numër A.nr.846/2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë: Rruga "Mbreti Zog" nr.42 A nga Komuna e Prizrenit, kundër Vendimit me Nr.01-112-134980 të datës 31.08.2021, të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, në çështjen juridike "*transferim i përkohshëm*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 17.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.846/2021 e datës 04.10.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. ANULOHET** Vendimit me Nr.01-112-134980 të datës 31.08.2021 i Kryetarit të Komunës së Prizrenit, për transferim të përkohshëm.
- III. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prizrenit, që ta bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit 15 dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në vendin e punës "Zyrtare Ligjore 2" në Drejtorin e Arsimit, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Komunë të Prizrenit, në vendin e punës: "Zyrtare Ligjore 2", në Drejtorin e Arsimit, me datë 31.08.2021 Kryetari i Komunës së Prizrenit ka nxjerrë Vendimin me Nr.01-112-134980, me të cilin ankuesen e ka transferuar përkohësisht në pozitë "Zyrtare për Shërbime Sociale", në Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Komunë të Prizrenit, sipas kërkesës së Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale e cila i është drejtuar Kryetarit të Komunës dhe Shefes së Kabinetit të Kryetarit, për staf shtesë për Qendrën për Punë Sociale.

Kundër Vendimit me Nr.01-112-134980 të datës 31.08.2021 të Kryetarit të Komunës të Prizrenit, ankuesja me datë 30.09.2021 përmes postës së Kosovës me numër R1863698 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 04.10.2021 me numër protokollit 4874/21, me pretendime ankimore se vendimi mbi transferimin e përkohshëm nuk është bërë konform dispozitave ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik dhe Rregullores (QRK) NR.14/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.10.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit. Komuna e Prizrenit me datë 11.11.2021 i është përgjigjur Këshillit në ankesën e ankueses përmes formës elektronike (E-mailit) duke bashkangjitur shkresat e lëndës dhe sqarimin nga njësia e personelit konform pretendimeve të ankueses.

**Kolegji për Shqyrtimin Ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 04.10.2021 me numër Anr.846/2021 të dorëzuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokollit 4874/2021, pliko e datës 30.09.2021 nr.R.1869698; Përgjigjja në ankesë e datës 11.11.2021 me sqarim nga njësia e personelit; Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt Emërimit nr.01-112-159027 i datës 17.11.2017; Dëshmi - kopje e flete dorëzimit për pranimin e vendimit për transferim; Kërkesa për procedurat e punësimit të zyrtarëve në QPS 1 dhe QPS 2; E-maili, Kërkesa për staf QPS 1 dhe QPS 2 i datës 05.07.2021; E-maili, Kërkesa e datës 28.10.2021 drejtuar Drejtorisë së Arsimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar shkresat e lëndës, përkatësisht Vendimin me Nr.01-112-134980 të datës 31.08.2021 për transferim të përkohshëm të ankueses, i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Prizrenit, me arsyetimin se transferimi i ankueses, është bërë për interes të institucionit sipas kërkesës (e-mailit) të datës 05.07.2021, nga Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, e cila i është drejtuar Kryetarit të Komunës dhe Shefes së Kabinetit të Kryetarit, për staf shtesë për Qendrën për Punë Sociale, duke bashkangjitur raportin dhe arsyetimin, i cili është bazuar në nenin 52 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet e ankueses e cila pretendon se transferimi i është bërë kundërligjshëm me ligjin, pa miratimin e Drejtorisë së Arsimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Prizrenit, me Vendimin me Nr.01-112-134980 të datës 31.08.2021, për transferimin e përkohshëm të ankueses nga pozita e Zyrtarit Ligjor 2, në Drejtorinë e Arsimit ankuesja është caktuar në pozitën "Zyrtarë për Shërbime Sociale", në Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, i cili vendim është nxjerr në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: **"1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, 1.1 kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve"** dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: **"8.Përshkrimi i përgjithshëm i punës për kategorinë Profesionale 1. Kategoria Profesionale është kategoria përgjegjëse për zbatimin e detyrave në përputhje me dispozitat ligjore, udhëzimet dhe procedurat e cila ofron mbështetje profesional edhe administrative, pa u përfshirë në përgjegjësi mbikëqyrëse. 2. Veprimtaria e përditshme kërkon njohuri të përgjithshme profesionale dhe administrative dhe/ose njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar"**, sepse dispozita e nenit 52 të Ligjit Nr.06L-114 për Zyrtarët Publikë, ku thuhet në mënyrë të përgjithësuar se **"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori"**, dhe kjo dispozitë është e ndërlidhur me nenin 5 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku është e përcaktuar se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga institucioni ku nëpunësi civil punon, siç thuhet se: **"1. Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të**

*transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar. 2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet”, udhëheqësi më i lartë administrativ është i obliguar që në zbatimin e kësaj dispozite të marr parasysh të gjitha dispozitat ligjor dhe specifikat e pozitës së lirë dhe plotësimin e kushteve ligjore të nëpunëses që të transferohet, në rastin konkret kur ankuesja është transferuar, në Drejtorin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka qenë e obliguar që të merr parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e ankueses që ka qenë në pozitë e “Zyrtares Ligjore 2”, në Drejtorinë e Arsimit, në raport me përshkrimin e detyrave për pozitën e “Zyrtares për Shërbime Sociale”, duke pasur parasysh dallimin e specifikës së punës në raport me kërkesat specifike të vendit të punës ku është transferuar nëpunësja.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se pretendimet e ankueses janë të qëndrueshme, sepse ankuesja sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me nr.01-112-159027 të datës 17.11.2017, mbanë pozitën: “Zyrtare Ligjore 2”, dhe me datë 31.08.2021 Kryetari i Komunës së Prizrenit, ankuesen e ka transferuar përkohësisht në pozitë “Zyrtare për Shërbime Sociale” në Drejtorinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sipas Vendimit me Nr.01-112-134980, me afat kohor 6 muaj, duke filluar nga data 01.09.2021 deri me datës 28.02.2022, sipas kërkesës së datës 05.07.2021 të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale, dhe se vendimi si i tillë ka të meta si në hyrje dhe arsyetim të tij, dhe është në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij sipas nenit 48 paragrafit 2 të këtij ligjit, dhe si i tillë është akt i paligjshëm, siç e përcakton nenin 52 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, 1.4 i këtij Ligji, ku përcaktohet se : **“1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”**, dhe se dispozitivi i tij nuk ka përcaktuar se ankuesja mund të kthehet në pozitën e saj të mëparshme sipas pretendimeve të ankueses, kjo është e qëndrueshme sepse e përcakton dispozita ligjore e nenit 52 paragrafi 6 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: **Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme”**, pas kalimit të periudhës së caktuar të transferimit të përkohshëm që është data 28.02.2022 e shfuqizimit, të cilin kthim e përcakton edhe dispozita e nenit 4 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: **“Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme”**, për faktin se ankuesja në pretendimet e saja është e dyshimt se nuk do ta kthejnë në pozitën e mëparshme sepse ajo thekson se i është zënë pozita me një zyrtar tjetër që ka punuar më parë në atë pozitë si “Zyrtar Ligjor”, që të cilin pretendim e vërteton dhe Njësia e Personelit e Komunës së Prizrenit, në përgjigjen e datës 11.11.2021 me nr.protokolli 5407/21, duke theksuar se në pozitën e ankueses është një zyrtar, duke deklaruar se : **“.....ka pas nevoj për jurist në Drejtorinë e Arsimit, .....pas largimit të zyrtares në fjal.....është transferuar një zyrtar tjetër nga sektori i pronës si Zyrtar Ligjor, në Drejtorinë e Arsimit”**, po ashtu lidhur me miratimin nga institucioni me rastin e transferimit të përkohshëm të ankueses është vërtetuar se nuk ka dëshmi siç e përcakton neni 5 paragrafin 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ku bëhet transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, të cilin pretendim e vërteton edhe përgjigjja e datës 11.11.2021 e Njesis së Personelit, ku deklaroi se ka bërë përpjekje për të siguruar këtë dëshmi por nuk ka marrë përgjigje nga Drejtoria e Arsimit, (e-maili i datës 28.10.2021).

Mbi këtë bazë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka konstatuar se Vendimi i Kryetarit të Komunës së Prizrenit me Nr.01-112-134980 i datës 31.08.2021, nuk ka vendosur në pajtim me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, por ka konstatuar në mënyrë të përgjithshme pa dhënë arsytetime të sakta dhe të qarta, kështu që arsyetimin e ka dhënë në kundërshtim me nenin 48 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të të njëjtit Ligj, andaj një dispozitiv dhe arsyetim

që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe është i paligjshëm në kundërshtim me nenin 52 të këtij Ligji, si rrjedhojë ka vepruar edhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtar Publik dhe 4 dhe 5 të Rregullores ( QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Andaj, Kryetari i Komunës së Prizrenit, nuk ka shqyrtuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e miratimit të kërkesës së datës 05.07.2021 (E-maili), nga Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, duke nxjerrë vendimin e datës 31.08.2021, për transferim të përkohshëm të ankueses, dhe mbi këtë bazë Kryetari i Komunës së Prizrenit është i obliguar që ankuesen ta kthej në pozitën "Zyrtare Ligjore 2" në Drejtorin e Arsimit, në pajtim me Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit me nr.01-112-159027 të datës 17.11.2017, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndal ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.846/2021 me datë 17.11.2021.



Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

